



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Te Fatosi Sh.P.K." të datës 01.12.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto 1) - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Te Fatosi Sh.P.K." të datës 01.12.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto 1) - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1 ashtu që **ANULOHE**t njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Te Fatosi Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 01.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi (loto 1) - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-9661-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. “AK ka kryer vizita tek tenderuesit për tu siguruar që artikujt e tyre të cilët do të instalohen e përmbushin 90% të ngjashmërisë me format vizuale të artikujve të paraqitur në paramasë. Në bazë të procesverbalit që e kemi siguruar me rastin e qasjes në dokumentet e tenderit, shihet që GOE GOE AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK nuk e kanë përmbushur kushtin e tillë pasi që nuk kanë arritur të ua dëshmojnë komisionit që figurat e ofertuara nga ky GOE janë të ngjashme me figurat e kërkuara nga AK së paku deri në masën 90%. Në raport shihet përfaqësuesi i GOE në fjalë ka konstatuar para komisionit se nuk i posedojnë por do të i kenë kinse të gatshme në fazën e implementimit të kontratës. Pra me vet faktin që ky GOE ka deklaruar në tender se modelet e figurave të tyre e plotësojnë 90% të pamjes vizuale në krahasim specifikimet teknike të figurave të paramasës, ndërsa gjatë vizitës në depot e tyre nuk ka qenë asnjë figurë e gatshme për prezantim, tregon se komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me ligjin kur nuk e ka cilësuar si mangësi mos posedimin dhe mos prezantimin e figurave të ofertuara. Komisioni i vlerësimit tek ne ka kërkuar të i shoh të gjitha mostrat të cilat edhe i ka fotografuar ndërsa tek GOE i shpallur fitues është mjaftuar vetëm me deklarimin e tyre që kinse gjatë implementimit të kontratës do të i sjellin ato siç janë kërkuar. Ky veprim i komisionit është jo ligjor sepse shihet që është aplikuar standard i dyfishitë në vlerësimin dhe verifikimin e dukjeve të figurave që ishin kërkuar nga AK. Me që deklarata për specifikimet teknike është pjesë e përshtatshmërisë profesionale dhe me që sipas të drejtës për vizitë është konstatuar se deklarata e tillë nuk është përmbushur, GOE në fjalë detyrimisht është dashur të eliminohet nga konkurrenca si tenderues i papërgjegjshëm”.

P.2. – “GOE GOE AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK posedon mangësi edhe tek pajisjet e ofruara pasi që nuk e plotëson kërkesën e AK-së për posedim apo marrje me qira me marrëveshje të rregullta të së paku dy shportave ngritëse për montim te ndriçimit dhe dekorimeve. Këtë e themi sepse Marrëveshjet për marrje me qira të shportave nga OE BINI CLEANERS SHPK dhe ETM GROUP SHPK nuk e kanë të përfshirë në marrëveshje emrin dhe numrin e prokurimit për çka janë paraqitur ndërsa shporta e OE BINI CLEANERS SHPK është edhe me afat të skaduar të regjistrimit. Me që kamioni i OE Agribau SHPK është vinç e jo shportë që si i tillë nuk pranohet, konstatohet se vetëm kamioni me shportë i OE ANEA SHPK e plotëson kushtin për tu konsideruar i pranueshëm. Nisur nga krejt kjo, konstatohet se GOE në fjalë nuk e ka plotësuar kriterin për pajisjet andaj ky GOE është dashur të cilësohet i papërgjegjshëm nga ana e komisionit të vlerësimit. Ja si duket librezja e regjistrimit pa afat e shportës së OE BINI CLEANERS SHPK dhe marrëveshjet për shporta pa emër dhe pa numër të prokurimit”.

P.3. – “GOE AGRIBAU SHPK & ANEA SHPK ka paraqitur një certifikatë që sipas të dhënave duket se ka skaduar një ditë pas hapjes publike. Edhe me rastin e verifikimit në faqen e lëshuesit të sajë tregohet njëjtë se kjo certifikatë tashmë është e skaduar dhe nuk është vazhduar me kohë. Ngjashëm duket edhe në faqen e lëshuesit të certifikatës nga ku në bazë të të dhënave vërtetohet se akoma nuk është bërë second surveillance e paraparë për datën 14.10.2025 dhe kjo tregon se certifikata nuk është vazhduar akoma. Sipas kësaj që shihet në informatat e tilla del që certifikata e tillë tashmë është e skaduar. Kjo konstatohet sidomos kur e shohim certifikatën që OE AGRIBAU SHPK e kishte paraqitur vitin e kaluar në tenderin e njëjtë ku tregohej se data e skadences ka qenë 13.11.2024 ndërsa data e parashikuar e first surveillance ishte 14.10.2024 (një muaj para skadimit). Me që në certifikatën e re nuk shkruan data e first surveillance por krahasuar me

certifikatën e vjetër shihet se ajo ishte vazhduar vetëm për një vit dhe atë deri me datën 13.11.2025. Tash me që nuk kemi të dhëna nga sistemi se second surveillance është kryer deri më tani, tregon qartë se certifikata pas datës 13.11.2025 është e skaduar sidomos kur dihet që second surveillance është dashur të kryhet me datë 14.10.2025 (një muaj para skadimit). Komisioni i vlerësimit është dashur të kërkoj certifikatën e vazhduar por e që nuk e ka bërë dhe me që akoma në sistem të verifikimit figuron certifikata me afat të skaduar, konsiderojmë se OE nuk e ka plotësuar kushtin e kërkuar nga AK për sa i përket ISO certificates”.

P.4. – “GOE ka ofertuar me çmime spekulative pasi që në disa pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta ndërsa në disa pozicione ka ofruar çmime shumë të larta. Po që se çmimet jo-normalisht të ulëta do ishin të përafërta me çmimet e tregut atëherë çmimi i tij do të dilte shumë më i lartë se çmimi jonë që duken qartë se janë çmime reale të tregut. Çmimet tek kjo tabelë janë çmime jo normalisht të ulëta që nuk ka asnjë mundësi teorike të liferohen me çmimin e tillë. Sidomos kur e marrim dhe e shikojmë përbërjen e figurës tek pozicioni 5, 18 dhe 30, shihet se edhe po të shitej për skrap me kilogram, ajo figurë arrin vlerën aq sa e ka ofertuar ky GOE. Pra bazuar në nenin 61 të LPP-së dhe në nenin 41 të RRPP-001/2022, komisioni i vlerësimit është dashur detyrimisht që të kërkoj sqarime për çmimet e tilla dhe të i kërkoj këtij GOE që të jap sqarime shtesë sidomos që të sqaroj çmimet e tilla sipas nenit 41.6, 41.7, 41.8 dhe 41.9 të RRPP-001/2022. Këtë veprim nuk e ka ndërmarr ndaj këtij GOE, andaj konsiderojmë se komisioni vlerësues me vetëdije e kanë shkelur dispozitën në fjalë. Këtë ka mundur lehtë të e vërej komisioni vlerësues sepse shihet që çmimet e tilla kanë diskrepancë të madhe me çmimet e tenderit tonë andaj kjo është dashur të nxit gjithsesi kureshtjen e komisionit të vlerësimit për të krahasuar çmimet e tilla me çmimet e tregut sepse kjo rrezikon shumë dështimin e furnizimit të figurave/pozicioneve të tilla dhe dështimin edhe të implementimit të kontratës në tërësi. Mjafton të i hidhet një sy kontratave të kaluara të AK-së apo edhe kontratave të AK-ve tjera ose edhe konsultimi me çmimet e tregut dhe do jetë e mjaftueshme për tu bindur që çmimet e tilla janë çmime jo-normalisht të ulëta. Përkundër kësaj që ky GOE ka ofrua çmime jo-normalisht të ulëta në disa nga pozicionet, është shqetësuese edhe fakti se në disa pozicione ka ofruar çmime **enorm të larta** në krahasim me çmimet e tregut dhe çmimet që vet AK i ka pasur të kontraktuara më herët për qëllimin e njëjtë. Bazuar në nenin 4.1.c të RRPP-001/2022, AK e ka për detyrë që **çdo herë të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut**. Kur këtë dispozitë e krahasojmë me disa nga çmimet e ofruara nga ky GOE të cilat shihen se janë me nga 500% më të larta se sa çmimet e tregut por edhe më të larta se çmimet që vet AK i ka kontraktuar në projektet e kaluara, lehtë konstatohet se AK po abuzon me paratë publike dhe po shkel plotësisht dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP-001/2022. Edhe neni 1 dhe 6 i LPP-së shumë qartë e tregojnë detyrimin e AK-së për mos kontraktim të çmimeve më të larta se çmimet e tregut andaj këtu nuk kemi se si të mos mendojmë se komisioni i vlerësimit ka qenë jashtëzakonisht neglizhent dhe jo profesional ndaj vlerësimit real dhe respektimit të dispozitave ligjore mbi administrimin e drejt të tenderëve dhe të parasë publike. Mjafton të shihen çmimet nga tabela e më poshtme ku janë përfshirë vetëm disa pozicione dhe posa të krahasohen me çmimet e tregut, me çmimet tona apo me çmimet që vet AK i ka pasur të kontraktuara më herët, do kuptohet që çmimet e tilla janë tepër më të larta se sa çmimet e tregut”.

Lidhur me P.1. – në dosjen e tenderit është kërkuar shprehimisht të deklarohet se tenderuesi duhet të ofroj artikujt sipas paramasës me ngjajshmëri së paku 90%. Për të vërtetuar këtë fakt, përmes pikës 9.3 të DT sipas informatave për tenderuesit, komisioni

vlerësues ka realizuar vizita në terren tek të gjithë OE ofertues. Sipas raportit të vlerësimit, komisioni vlerësues gjatë vizitës te tenderuesi i rekomanduar ka gjetur si në vijon: *"Komisioni i vlerësimit, me datë 21.11.2025, ka dalë në terren dhe ka vizituar të dy kompanitë ofertuese me qëllim të verifikimit nëse i posedojnë materialet ose mostrat sipas dizajnit të përcaktuar në aneksin 1 të njoftimit për kontratë dhe paramasës. Gjatë vizitës në kompaninë "Agri Bau shpk & Anea Group shpk", nuk është dëshmuar se posedojnë ndonjë dizajn apo mostër sipas aneksit 1 dhe paramasës... Komisioni i vlerësimit për këtë aktivitet ka ndarë mendime të ndryshme: kryesuesi i komisionit propozon dhënien e kontratës për ofertën "Te Fatosi shpk" pasi që bazuar në aneksin 1 dhe paramasën, kjo është oferta e vetme e përgjegjshme. Ndërsa dy anëtarët e tjerë të komisionit propozojnë ofertën "Agri Bau shpk & Anea Group shpk".*

Duke marrë parasysh këto konstatime në raportin e komisionit vlerësues, është e pamundur të konfirmohet nëse artikujt që do të liferohen nga tenderuesi i rekomanduar do të jenë ose jo të ngjashëm së paku 90% me artikujt e përcaktuar sikurse në paramasë. Në këtë mënyrë nuk mund të konfirmohet nëse tenderuesi i rekomanduar i ka përmbushur kërkesën sipas aneksit 1 të DT. Për këto arsye, ky pretendim ankimor është gjetur si i bazuar.

Lidhur me P.2. – është gjetur se kamioni me targa 01-507-QI është pa regjistrim i cili është marrë me qera. Po ashtu është gjetur se marrëveshjet me qera janë të përgjithshme dhe nuk i referohen ekskluzivisht këtij aktiviteti të prokurimit. Megjithatë tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar edhe 2 makina të tjera. Prandaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar ndërsa komisioni i rivlerësimit duhet të konfirmoj nëse është përmbushur edhe kjo kërkesë e DT nga tenderuesi i rekomanduar.

Lidhur me P.3. – është gjetur se certifikata ISO 900-2015 e prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar aktualisht është me afat të skaduar. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me P.4. – përmes nenit 41.4. të RRPP përcaktohet se *"Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së"*. Nga pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se në paramasën e tenderuesit të rekomanduar ka pozicione ku një bredh është ofertuar me çmimin prej 10,000 euro (poz. 12) dhe një tjetër me 9,000 euro (poz. 17) ndërsa në pozicione tjera është ofertuar p.sh dekorimi me konstruksion metalik me gjerësi 9 metra dhe lartësi 2,35 me gjithsej 20 fusha dekorative për vetëm 700 euro (poz. 24) apo pozicioni tjetër për furnizim dhe montim të dritave dekoruese të verdha në gjithë sheshin nënë tereza me distancë 10-15 cm në mes të shiritave për vetëm 4 euro (poz. 20). Rrjedhimisht është gjetur se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar mirëpo komisioni rivlerësues duhet të konfirmoj nëse çmimet janë jonormalisht të ulëta sipas nenit 41 të RRPP dhe 61 të LPP apo jonormalisht të larta sipas 4.1.c të RRPP ku thuhet se AK duhet të sigurohet se *"të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.12.2025

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.